



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 19.05.2025

Numër Protokolli: 3261/2025

A.nr.476/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.476/2025 të datës 17.03.2025 të parashtruar nga ankuesja H.J-G, kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*Vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.476/2025 e datës 17.03.2025 e parashtruar nga ankuesja H.J-G.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile H.J-G (në tekstin e mëtejme referuar ankuesja) më datë 17.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1726/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga Drejtorja e Sekretarisë Ekzekutive e Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.04.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, ndërsa Këshilli më datë 28.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 29.04.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1726/2025 të datës 17.03.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letërnjoftim i H.J.G.; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil i H.J.G. i datës 28.02.2025; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i H.J. i datës 20.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i H.J. i datës 27.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i H.J. i datës 24.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i H.J. i datës 23.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i H.J.G. i datës 23.01.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i H.J.G. i datës 23.01.2024; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i H.J.G. i datës 23.01.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 04.04.2025; Përgjigje në ankesë i datës 28.04.2025; Akt Emërim i H.J. i datës 21.09.2012; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i H.J. i datës 22.08.2013; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i H.J. i datës 04.08.2015; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i H.J. i datës 07.08.2018; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i H.J.G. i datës 18.01.2021; Akt Emërim i H.J.G. i datës 06.01.2025; Përshkrimi i punës; Formulari i përshkrimit të punës; E-mail nga A.B. për S.A. i datës 04.03.2025; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 03.03.2025; Vendim i zv. Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të AKKVP me numër Ref.nr.00102/23shs i datës 01.02.2023; Vendim i Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të AKKVP me numër Ref.00955/23 i datës 01.08.2023; E-mail nga S.A. për H.J. i datës 14.02.2025; Kërkesë për transferim të përkohshëm i datës 22.08.2023; Transferim i përkohshëm në BNJ i datës 22.08.2023; Vendim nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në AKKVP me numër Ref.Nr.01064/23/shr i datës 22.08.2023; Vendim për themelimin e komitetit të auditimit në AKKVP me numër Ref.00919/23 i datës 01.08.2023; E-mail nga S.A. për H.J. i datës 10.02.2025; Vendim i Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të AKKVP me numër Ref.nr.ref.01465/23 i datës 06.11.2023; Vendim i Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të AKKVP me numër Ref.00840/24; E-mail nga H.J. për A.B. etj. i datës 23.02.2024; Raporti javor 19-23 shkurt 2024; E-mail nga H.J. për A.M. etj. i datës 07.12.2023; E-mail nga A.A. për Kpcva.management i datës 04.12.2023; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 13.11.2024; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 20.01.2025; E-mail nga A.B. për H.J. i datës 20.01.2025; E-mail nga H.J. për Kpcva.management etj. i datës 20.01.2025; E-mail nga H.J. për Kpcva.management etj. i datës 15.01.2025; E-mail nga H.J. për Kpcva.management etj. i datës 15.01.2025; Kompensim i kryesueses dhe anëtarëve të komitetit të auditimit të AKKVP me numër Nr.ref./25/hj i datës 03.02.2025; E-mail nga H.J. për S.A. i datës 03.02.2025; E-mail nga S.A. për H.J. i datës 03.02.2025; E-mail nga H.J. për S.A. i datës 03.02.2025; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 13.11.2024; E-mail nga H.J. për D.D. i datës

15.11.2024; E-mail nga D.D. për H.J. i datës 15.11.2024; E-mail nga H.J. për A.I. etj. i datës 15.11.2024; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 03.10.2024; E-mail nga A.B. për H.J. etj. i datës 03.10.2024; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 02.10.2024; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 02.10.2024; E-mail nga kosova news për H.J. etj. i datës 02.10.2024; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 21.01.2025; Formular i raportimit vjetor lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike i AKKVP i datës 31.01.2025; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 21.01.2025; E-mail nga A.B. për H.J. i datës 21.01.2025; E-mail nga H.J. për A.B. i datës 21.01.2025; Vendim për shtyrje të afatit i KPMSHCK me numër protokolli 2847/2025 i datës 29.04.2025; Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtuar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e palejuar sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Ndryshim dhe plotësimit të Akt Emërimit të datës 18.01.2021 ankuesja mbanë pozitën e punës Zyrtar Ligjor në Njësinë për përpunimin e kërkesave në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se Drejtorja e Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës, më datë 28.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024 dhe atë në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit arrin pritshmërinë.

Ankuesja në ankesën e parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga Drejtorja e Sekretarisë Ekzekutive e Agjencisë Kosovare për Krahassim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2024, respektivisht ndaj pikave të shënuara në tabelën nr. III pikat 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 si dhe tabela nr. IV pika 1.1 e njëjta thekson se nuk pajtohet me pikat e shënuara dhe të njëjtat i kundërshtoj pasi që nuk janë në përputhje me realitetin dhe faktet që e pasqyrojnë punën time, kjo mund të vërtetohet me vlerësimet të mëparshme të viteve 2019, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025 me notën mesatare 4.5, 4.7 dhe 5 të cilat reflektojnë më saktë performancën time, kërkon të rishikohet vlerësimi i bërë për vitin 2024 respektivisht tabelat e cekura të përmirësohet komenti ka nevojë për përmirësim dhe të vendoset arrinë pritshmërinë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike administrative ju referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, respektivisht:

Neni 52 paragrafi 2, 3, 4, 5, 6, 13, 14, 15, dhe 17, përcakton se: “2. *Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues.* 3. *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës.* 4. *Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave.* 5. *Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe*

përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme. 14. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafëve 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, për përmirësimin e aftësive profesionale, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, miraton trajnimet e detyrueshme, që nëpunësja/i duhet t'i ndjekë vitin që vjen dhe sipas vlerësimit mund të ofrojë edhe rekomandime për transferimin me qëllim të përmirësimit të rezultateve të punës. 15. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. përpos trajnimeve të detyrueshme, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me NjMBNj-në e institucionit, vendos që nëpunësja/i civil i nënshtrohet një vlerësimi të veçantë. 17. Nëpunësja/i civil e cila nuk është e kënaqur me vlerësimin si në paragrafin 13. nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK, sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”.

Andaj duke marrë parasysh Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses të datës 28.02.2025 e cila vlerësohet në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit Arrin pritshmërinë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja ka arritur pritshmërinë siç parashihet me nenin 52 paragrafi 13 nën paragrafi 13.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si rezultat i kësaj nëpunësi civil i cili nuk është i kënaqur me vlerësimin e rezultateve të punës ka të drejtë të paraqesë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vetëm në rastet kur vlerësimi i nëpunësit civil rezulton të jetë vlerësuar sipas niveleve të parashikuara me nenin 13 paragrafi 13.4 dhe 13.5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit, konstaton se meqë ankuesja është vlerësuar në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit Arrin pritshmërinë, atëherë Kolegji i Këshillit duke ju referuar paragrafit 17 të nenit 52 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, konstaton se në këtë rast nuk lejohet parashtrimi i ankesës për këtë çështje, andaj referuar dispozitave të lartcekura po ashtu edhe dispozitave të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “1. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji”, kështu që meqë ankesa në rastin e tillë është përjashtuar shprehimisht me ligj, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa me numër A.nr.476/2025 e datës 17.03.2025 e parashtruar nga ankuesja është e palejuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.476/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses H.J-G;
- Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.